



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 46

**Tiranë – E premte, 25 mars 2022**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                          | Faqe                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Udhëzim i ministrit të Turizmit<br>dhe Mjedisit nr. 1, datë 24.3.2022                                    | Për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimin e ndotjes në<br>mjedis dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, caktimin e ditës pa<br>makina..... 7011                                                             |
| Udhëzim i përbashkët i ministrit të<br>Brendshëm dhe i ministrit të<br>Drejtësisë nr. 39, datë 16.3.2022 | Për modalitetet e nevojshme organizative dhe teknike për ofrimin e<br>ndihmës juridike të garantuar nga shteti kërkuesit për mbrojtje<br>ndërkombëtare..... 7011                                                   |
| Urdhër i drejtorit të përgjithshëm<br>të Arkivave nr. 195, datë 18.3.2022                                | Për delegim kompetencash..... 7012                                                                                                                                                                                 |
| Vendim i Entit Rregullator të<br>Energjisë nr. 36, datë 3.3.2022                                         | Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit për licencimin e shoqërisë<br>“Lajthiza Invest” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë<br>elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw..... 7013 |
| Vendim i Entit Rregullator të<br>Energjisë nr. 37, datë 3.3.2022                                         | Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ADA Solar<br>SE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 7014                                                                       |





## UDHËZIM

Nr. 1, datë 24.3.2022

**PËR NEVOJA TË MBROJTJES SË  
MJEDISIT, PARANDALIMIN E  
NDOTJES NË MJEDIS DHE  
PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT,  
CAKTIMIN E DITËS PA MAKINA**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 7, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1989, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”; si dhe bazuar në VKM-në nr. 112, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, brenda fushës së përgjegjësisë për mbrojtjen e mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit

## UDHËZON:

1. Kryetarët e Njërive të Vetëqeverisjes Vendore, për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimit të ndotjes në mjedis dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit, të marrin masat e nevojshme për kufizimin e përkohshëm të qarkullimit, **të dielën e parë të çdo muaji**, të të gjitha kategorive të mjeteve private, në zonat e banuara, në njësitë përkatëse që ata administrojnë.

2. Për realizimin e iniciativës së ditës pa makina, njësitë e vetëqeverisjes vendore respektive, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, përcaktojnë masat, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të Kodit Rrugor, por pa u kufizuar, në:

a) kategorinë e zonës, në të cilat do të vendoset ndalimi i qarkullimit të mjeteve;

b) kategorinë e mjeteve të parashikuara nga Kodi Rrugor, për të cilat duhet të ndalohet qarkullimi;

c) orën nga e cila fillon dhe përfundon masa e përkohshme e ndalimit të qarkullimit.

3. Kryetarët e njërive të vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e strukturës përgjegjëse lokale për zbatimin e masave për rregullimin e qarkullimit të mjeteve në qendrat e banuara, miratojnë urdhëresë të veçantë, të motivuara, për rregullimin e

qarkullimit të dielën e parë të çdo muaj, si ditë pa makina në qendrat e banuara.

4. Kryetarët e njërive të qeverisjes vendore informojnë me të gjitha mjetet dhe format informuese për realizimin e kësaj nisme banorët e njërive administrative, brenda juridiksionit territorial të tyre.

5. Ngarkohen kryetarët e njërive të vetëqeverisjes për zbatim të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
**Mirela Kumbaro Furxhi**

**UDHËZIM I PËRBASHKËT  
Nr. 39, datë 16.3.2022**

**PËR MODALITETET E NEVOJSHME  
ORGANIZATIVE DHE TEKNIKE PËR  
OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË  
GARANTUAR NGA SHTETI KËRKUESIT  
PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 58, pika 4, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Drejtësisë

## UDHËZOJNË:

1. Kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, në çdo fazë të procedurës për përcaktimin e statusit, në kushtet e pamundësisë financiare për të mbuluar shpenzimet përkatëse, i ofrohet ndihma juridike falas e garantuar nga shteti.

2. Kërkuesit i ofrohet ndihma juridike falas e garantuar nga shteti, në lidhje me:

a) informacionin për të drejtat dhe detyrimet e tyre;

b) hartimin e ankimeve për vendimet që merren gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës;

c) hartimin e akteve dhe përfaqësimin në procedurat administrative para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe para gjykatës për ankimin e vendimeve të marra gjatë shqyrtimit të kërkesës.



3. Ndhimën juridike, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, mund ta japin ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

4. Kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare, që plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën “h”, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, konsiderohet përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas.

5. Kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare i ofrohet ndihmë juridike parësore ose dytësore, në varësi të shërbimit të kërkuar, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

6. Kërkesa për ndihmë juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare, pranë qendrave, që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore, organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga ministri i Drejtësisë ose klinikave ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

7. Për të përfituar ndihmën juridike parësore, kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare nënshkruan një vetëdeklarim, sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues.

8. Kërkesën për ndihmë juridike dytësore, kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare e paraqet personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës.

9. Kërkesa, sipas pikës 8 të këtij udhëzimi, mund të paraqitet edhe nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es, ose një të afërmi të shkallës së parë.

10. Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare nënshkruan një vetëdeklarim, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues.

11. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe për refugjatët, me kërkesë të kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, e asiston në plotësimin e dokumentacionit procedural të nevojshëm për përfitimin e ndihmës juridike falas parësore apo dytësore, deri në përfundimin e procedurave

ligjore për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe të garantimit të aksesit të kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare në ndihmën juridike falas, me qëllim zbatimin efektiv të parashikimeve ligjore në fuqi që lidhen me ofrimin e ndihmës juridike falas.

12. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të bashkëpunojë me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për lehtësimin e aksesit të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, me qëllim ofrimin e ndihmës pranë institucioneve rezidenciale, ku janë të strehuar kërkuesit.

13. Procesverbalet e mbajtura gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore apo organizatat jofitimprurëse të autorizuara i vendosen në dispozicion autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

14. Ngarkohen Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dhe autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Ministrinë e Brendshme për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM  
Bledar Çuçi

MINISTËR I DREJTËSISË  
Ulsi Manja

URDHËR  
Nr. 195, datë 18.3.2022

#### PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,



## URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Arben Dervishllari, drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 23.3.2022 deri në datën 25.3.2022.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t'ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
**Ardit Bido**

**VENDIM**  
**Nr. 36, datë 3.3.2022**

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË  
BORDIT PËR LICENCIMIN E  
SHOQËRISË “LAJTHIZA INVEST” SHA,  
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC  
“QAMI 1”, ME KAPACITET TË  
INSTALUAR 1.730 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të

Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 322/3 prot., datë 28.2.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 11, datë 21.1.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, në përroin e Srriqes, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqes, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës.

- ERE, me shkresën nr. 70/2 prot., datë 21.1.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e procedurës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e treta (data 4.2.2022), nuk rezultoi të ketë pasur të tilla.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 11/3 prot., datë 2.2.2022, nr. 11/5 prot., datë 17.2.2022, dhe nr. 11/6 prot., datë 25.2.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion dhe informacion, sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Lajthiza Invest” sh.a. rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, ghermat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar;



- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”: plotësuar;

- dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, germat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”: plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- Me qëllim sqarimin e konstatimeve në lidhje me dokumentacionin që ka të bëjë me dokumentacionin pronës (neni 9, pika 2, germa “g”) dhe studimin e fizibilitetit (neni 9, pika 4.1.4, germa “g”) dhe në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet e arsyeshme të zgjatet me 10 ditë pune vendimmarrja e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.p.k., për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të zgjasë me 10 (dhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.p.k., për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrît Ahmeti

#### VENDIM Nr. 37, datë 3.3.2022

#### MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ADA SOLAR SE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 322 prot., datë 28.2.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “ADA Solar SE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “ADA Solar SE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 275 prot., datë 17.2.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, aplikanti duhet të depozitojë në ERE këtë dokumentacion: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar;



- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germet “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ADA Solar SE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë